



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 20, datë 17.08.2020

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS REGLETA PANAJOTI, NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DATËN 28.08.2018 DHE RISHPALLUR NË DATË 21.08.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

<b>Vitore Tusha</b>	- zëvendëskryetare
<b>Fiona Papajorgji</b>	- anëtare
<b>Arta Marku</b>	- anëtare
<b>Miranda Andoni</b>	- anëtare
<b>Saida Dollani</b>	- anëtare/relatore
<b>Ludovik Dodaj</b>	- anëtar
<b>Fatjona Memçaj</b>	- anëtare
<b>Arjan Qafa</b>	- anëtar

Asistuar nga sekretare **Vilma Dokushi**,

Pa praninë e Avokates së Popullit, **znj. Erinda Ballanca**, e njoftuar rregullisht për zhvillimin e mbledhjes,

Me praninë e përfaqësueses së autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **znj. Katrin Treska**, përfaqësuese e autorizuar e Presidentit të Republikës,
- në mungesë të përfaqësuesve të tjerë të subjekteve të ftuara sipas ligjit,

**në mbledhjen e datës 17.08.2020**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATES PËR GJYQTARE  
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

**Znj. Regleta Panajoti,**

**OBJEKTI:**

**Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të znj. Regleta Panajoti, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.**

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së Këshillit, **Saida Dollani** si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 28.08.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit të kandidaturave, me vendimin nr. 115, datë 09.08.2019, vendosi:

- *Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.*

3. Sipas vendimit nr. 115, datë 09.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës, si dhe pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, Kuvendi i Republikës, në datën 21.08.2019, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

4. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

5. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Regleta Panajoti.

6. Në zbatim të neneve 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/c, të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 2, 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016), si edhe të pikës 98 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 21.09.2019, vendosi fillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.

7. Në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016) dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 21.09.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese.

8. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zoti Fatri Islamaj. Gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant, rezultoi se relatori, Fatri Islamaj, me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datën 10.12.2019 është shkarkuar nga detyra. Në kushtet kur ligji parashikon pezullimin e menjëhershëm nga detyra të gjyqtarit, për shkak të këtij vendimi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 11.12.2019 ka realizuar përsëri shortin manual. Sipas shortit, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Vitore Tusha.

9. Znj. Regleta Panajoti, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, të ndryshuar, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Regleta Panajoti, gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

10. Në datën 24.09.2019, kandidatja Regleta Panajoti është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidates në deklaratën përkatëse të datës 24.09.2019, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

11. Në datën 30.09.2019, kandidatja Regleta Panajoti ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

12. Duke qenë se kandidatja Regleta Panajoti ka qenë gjyqtare, ajo njëherazi ka qenë edhe subjekt i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës, si dhe pikës 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, (në vijim ligji nr. 84/2016). Për çka dhe procesi i vlerësimit të znj. Regleta Panajoti, si subjekt i rivlerësimit, është kryer nga institucionet e rivlerësimit të parashikuara nga neni 5 i ligjit nr.84/2016.

13. Për rrjedhojë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për sa i përket vlerësimit dhe kontrollit të pasurisë dhe të figurës, bazuar në pikën 64 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, ka marrë parasysh konkluzionet e realizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Ky i fundit, me Vendimin nr. 169, datë 26.06.2019 ka vendosur:

*“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Regleta Panajoti, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*

Nga përmbajtja e vendimit rezulton se shqyrtimi i subjektit të rivlerësimit ka përfshirë vlerësimin pasuror, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin profesional.

14. Vendimi nr. 169, datë 26.06.2019 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është ankimuar nga Komisioneri Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, ku është regjistruar çështja (JR) nr. 51/2019, datë 17.10.2019.

15. Për shkak të përfundimit të mandatit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) 2019, zhvillimi i procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant i kaloi Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020, i cili në datën 15.01.2020 zhvilloi shortin manual dhe relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, është caktuar anëtarja e Këshillit, Saida Dollani. Sipas parashikimit të pikës 5/2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, të ndryshuar, relatorja kontrolloi saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera dhe konfirmoi veprimet e kryera nga relatorët e mëparshëm.

16. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në pikën 1/1 të nenit 20 të Rregullores *“Për Veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”*, të ndryshuar, me aktin shkresor nr.8 Prot, datë 13.01.2020, i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 51/2019 datë 17.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Regleta Panajoti.

17. Me aktin shkresor nr. 24/1 Prot, datë 22.01.2020, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se, *‘...bazuar në pikën 1/1 të nenit 20 të rregullores’ ‘Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit’, pasi e mori në shqyrtim kërkesën tuaj, vendosi përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes nr. 51/2019, datë 17.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Regleta Panajoti’*.

18. Me shkresën nr. 463/42 regj., datë 04.08.2020, Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ka dërguar për njoftim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kopjen e vendimit me arsyetim të përmbledhur nr. 19, datë 30.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Regleta Panajoti, me të cilin ka vendosur:

- “1. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.169, datë 26.06.2019, për subjektin e rivlerësimit Regleta Panajoti.*
- 2. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Regleta Panajoti.*
- 3. Ndalimin e emërimit të znj. Regleta Panajoti gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15 – vjeçare.*
- 4. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.”*

19. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit, dhe verifikimeve të sipërcituara, nisur nga gjendja që rezulton nga kjo procedurë verifikimi për kandidaten Regleta Panajoti, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 104 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, të ndryshuar, është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës për ndalimin e kandidimit duke e dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

20. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, të ndryshuar, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.08.2020, ora

11:00, rendin e ditës, si dhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt verifikimin e procedurës së mëtejshme të kandidimit të kandidatës Regleta Panajoti, për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo, vakancë e shpallur në datën 28.08.2018 dhe e rishpallur në datën 21.08.2019, sipas gjetjes të sipërpërmendur.

21. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Regleta Panajoti, nëpërmjet postës elektronike zyrtare.

22. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori për veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet e çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

23. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.08.2020, ora 11:00, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që, sipas ligjit, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

24. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

## **II. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

25. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator, i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, vlerëson se duhet të vendosë ndalimin e kandidimit për zonjën Regleta Panajoti.

26. Në pikat 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

*“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”*

27. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

*a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*

*b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*

- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral. ”.

28. Në zbatim të pikave 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, të pikave 1 dhe 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në përfundim të afatit të caktuar të shpalljes “Për hapjen e Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi ka administruar dokumentacionin e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë pozicion, ka filluar në datën 21.09.2019 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kritereve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

29. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 24 dhe 25 më sipër, duhet të plotësohen secili dhe të gjithë së bashku ,në mënyrë që kandidati të pranohet për t’u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për t’u përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

30. Për rrjedhojë, nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte shkak ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

31. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidaten Regleta Panajoti, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 7/a.pika1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së saj personale, dhe të familjarëve së saj, sipas ligjit.

32. Kandidatja Regleta Panajoti ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rrjedhojë, ajo ka qenë njëherazi edhe subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës, si dhe pikës 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Prandaj, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe Aneksit të saj “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve” të saj, si dhe ligjit nr. 84/2016, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për sa i përket verifikimit dhe kontrollit të pasurisë dhe të figurës, merr parasysh dhe mbështetet në konkluzionet e realizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit. Kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve për subjektet e rivlerësimit është kusht ligjor pa të

cilin nuk mund të procedohet me lejimin e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, sipas shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

33. Siç është përshkruar fakti në paragrafët e mësipërm ( §11, 12 dhe 16 të këtij vendimi), në procesin e rivlerësimit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 169, datë 26.06.2019, ka vendosur të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit, Regleta Panajoti, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Mirëpo, mbi ankimin e Komisionerit Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr. 19, datë 30.07.2020, ka vendosur përfundimisht:

1. *Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.169, datë 26.06.2019, për subjektin e rivlerësimit Regleta Panajoti.*
2. *Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Regleta Panajoti.*
3. *Ndalimin e emërimit të znj. Regleta Panajoti gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15 – vjeçare.*
4. *Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.”.*

34. Në vendimarrjen e tij, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se në datën 24.06.2020, subjekti i rivlerësimit Regleta Panajoti, nëpërmjet komunikimit elektronik njoftoi Kolegjin e Posaçëm të Apelimit lidhur me kërkesën e saj drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, për dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Po ashtu, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vlerësuar se vendimi nr. 239, datë 07.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka sjellë pasojë ligjore mbarimin e statusit të magjistratit dhe ka çmuar se si pasojë e sa më sipër, znj. Regleta Panajoti ka humbur cilësinë e subjektit të rivlerësimit *ex officio*, për shkak të cilit ajo u përfshi në procesin e rivlerësimit kalimtar, në kuadër të parashikimeve të nenit 179/b të, pika 3 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, arsyeton Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në zbatim të parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, procesi i rivlerësimit duhet ndërprerë dhe ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit nga detyra, në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, sjell si pasojë ndalimin e saj për t’u emeruar gjyqtar i çdo niveli.

35. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës sistemi i rivlerësimit është ngritur me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi ndaj të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

36. Për këto arsye, përballur faktin e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten Regleta Panajoti dhe ndalimin e emërimit të saj për gjyqtar i çdo niveli, për një periudhë 15 – vjeçare me vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me dispozitën ligjore të parashikuar nga neni 5 i ligjit nr. 84/2016, që në mënyrë eksplicite përcakton se: “ *Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë*”, si dhe me kushtin ligjor të parashikuar në shkronjën “dh” të pikës 1, të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, Këshilli vlerëson se znj. Regleta Panajoti nuk e ka kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe të verifikimit të pasurisë së saj personale dhe të familjarëve të saj, sipas ligjit.

37. Në të njëjtin përfundim arrin Këshilli edhe në referim të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e*

verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, i cili në pikën 104 parashikon se:

“104. Kandidatët magistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, për të cilët nuk është dhënë vendim nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit nga Këshilli. Vendimi i Këshillit, për urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit sipas neneve 235 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016 për këta kandidatë, do të mbështetet në vendimin përfundimtar të rivlerësimit kalimtar.”.

38. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më lart, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatës Regleta Panajoti për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të neneve 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 1, shkronja “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229, pikës 3 të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 50, shkronja “b”, dhe 51 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

### **VENDOSI:**

1. Ndalimin e kandidimit të znj. Regleta Panajoti, për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Regleta Panajoti.
3. Kandidatja Regleta Panajoti ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

